



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

UDHËZIM

Nr. prot 2542/1

Nr. 04, datë 20.05 2022

“PËR

**DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 18.06.2021 “MBI PËRDORIMIN E
SISTEMIT DINAMIK PËR BLERJEN E BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR
NDËRKOMBËTAR DHE ZHVILLIMIN ME MJETE ELEKTRONIKE”**

Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të nenit 23, 54/1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 68/9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

UDHËZON:

1. Në pikën 6, shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të kërkojë kritere të veçanta për kualifikim/specifikime teknike, duhet të përcaktojë në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues. Ftesa për Ofertë, sëbashku me procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimin publikohen në Sistemin e Prokurimit Publik”.

2. Pas pikës 12 shtohet pika 13 me këtë përmbajtje:

“Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e Protokollit të autoritetit/entit kontraktor”.

3. Ky udhëzim publikohet në faqen e APP dhe hyn në fuqi në datë 26.5.2022

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

